



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.05.2025, Operatori Ekonomik T & CO GROUP **SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "T & CO GROUP" SH.P.K., e dt.16.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 03.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Korigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 03.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "T & CO GROUP" SH.P.K., me dt.16.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ky pretendim është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me Udhëzuesin nr.001/2023 për Prokurim Publik, nenin 8 pika iv:

-“Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

*Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush **se paku 51%** e këtij qarkullimi minimal”*

Dëshmia e kërkuar dokumentare – është e pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me Udhëzuesin nr.001/2023 për Prokurim Publik, nenin 8 pika ii nën d dhe e :

“ d. Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose

e. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i themelimit.”

2. Pretendimi i dytë është i pabazuar sepse Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me Udhëzuesin nr.001/2023 për Prokurim Publik, nenin 8 pika iv:

-“Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

*Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontratë se lideri i grupit preferohet të përmbush **se paku 51%** e këtij qarkullimi minimal”*

3. Pretendimi i tretë: pjesërisht e bazuar – a) OE duhet të jetë i pajisur me Licencë valide për prodhim zhavorri (guri ose shkëmb i fortë) ose marrëveshje për furnizim nga Operatori i licencuar.
Pika b) pjesërisht e bazuar – përmirësohet kërkesa .
4. Pretendimi i katërt: Bazuar në përshkrimin teknik të Projekti kryesor të liqenit në lumin Erenik, – pika 5. Modelimi hidraulik i vërshimeve për liqenin dhe pendën, ceket se: “Fushat dhe hapësirat tjera përgjatë shtratit të lumit Erenik janë subjekt i përmbytjeve” për këtë arsye është kërkuar një person i certifikuar me certifikata të cekuar si në dosje të tenderit - certifikata të lëshuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Ekonomisë.
5. Pretendimi i pestë: Pajisja e kërkuar është pajisje adekuate për natyrën e punimeve, ndërsa specifikat e saj janë kërkuar në minimum, ndërsa si auto mjet duhet patjetër të jetë i rexhistruar me librezë valide.
6. Pretendimi i gjashtë: pjesërisht e bazuar – të largohet sistemi laserik i kontrollit dhe mbetet Makinë shpuese gjeoteermale për punime- shpime horizontale dhe vertikale.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit